



**VENDIM**

Nr. 111, Datë 05.07 2017

**MBI MIRATIMIN E KRITEREVE TË KONKURIMIT PËR POZICIONIN  
"ADMINISTRATOR" I UNIVERSITETIT TË ARTEVE**

Në mbështetje të Ligjit Nr.80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL në RSH", neni 49 pika 1/f, neni 49 pika 1/g dhe neni 51 pika 2, Bordi i Administrimit në mbledhjen e datës 05.07.2017, pasi shqyrtoi projekt vendimin paraqitur nga Kryetaja e Bordit të Administrimit, me votim të lire dhe unanim,

**VENDOSI:**

1. Miratimin e kriterëve të për shpalljen e konkursit për vëndin e punës "Administrator i Universitetit të Arteve të Tiranës" sa më poshtë vijon;

➤ **KRITERE KUALIFIKUESE**

**Konkurentët duhet të plotësojnë këto kriterë:**

1. Të kenë përfunduar Arsimin e Lartë në fushën e Drejtësisë ose Ekonomikë së paku në nivelin "Master I Shkencave" (ose diplomë e Integruar sipas ligjit 80/2015);
2. Të kenë përvojë pune së paku shtatë vjet në këto fusha;
3. Të mos kenë lidhje apo konflikt interesi me drejtuesit e Universitetit, Bordit të Administrimit dhe Drejtuesit e MAS-it.
4. Të kenë trajnime, kualifikime të ndryshme në fushën e menaxhimit ose administrimit në arsim.
5. Të ketë vlerësime positive nga punësdhënësit e mëparshëm
6. Të zotërojnë gjuhë të huaj (preferohet anglishtja), nga Fakulteti I Gjuhëve të Huaja ose nga





7. Provime ndërkombëtare.
8. Paraqitja e një platform zhvillimi për administrimin ekonomik dhe financiar të Universitetit.

**Shënim:**

- Në rast se candidate nuk plotësojnë kriteret kualifikuese që parashikohen tek Ligji i Arsimit të Lartë (80/2015), nga të cilat 1-4 janë kriteret bazë dhe kandidati nuk mund të pranohet për konkurim për intervistën, kriteret nga 5-8 janë kriterë preferencialë.

*Mos plotësimi i kriterëve bazë nga 1-4 përbën shkak për skualifikimin e kandidaturave që do t'i përcillen Bordit të Administrimit nga Senati Akademik.*

➤ **DOKUMENTACIONI I DOMOSDOSHËM**

**Konkurentët duhet të dorëzojnë në dosjet e tyre dokumentacionin për sa më poshtë vijon:**

1. Letër-motivimi për pozicionin e punës, për të cilin do të konkurojë.
2. Dokumentin e identifikimit (fotokopje e noterizuar).
3. Curriculum vitae (në formatin Europass)
4. Diplomën e shoqëruar me listën e notave (të noterizuar). Kandidatët që kanë përfunduar studimet jashtë vendit, duhet të kenë bërë njohjen e diplomës.
5. Letër reference nga punëdhënësi.
6. Deklaratë që nuk ka konflikt interesi me drejtuesit e Universitetit, Bordit të Administrimit dhe Drejtuesit e MAS-it.
7. Librezën e punës që vërteton përvojën e punës.(fotokopje e noterizuar).
8. Dëshmi penaliteti ose vetëdeklarimi.
9. Të plotësojë Formularin e vetdeklarimit në zbatim të Ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e Integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".
10. Çertifikata/Diplomë trajnimesh apo kualifikimesh pasuniversitare në fushën përkatëse (nëse ka), të noterizuara.
11. Dëshmi të gjuhëve të huaja (nëse ka) nga Fakulteti I Gjuhëve të Huaja ose nga provime





ndërkombëtare. (e noterizuar).

13. Çdo gjë që deklarohet në CV të jetë e dokumentuar dhe e noterizuar.

#### ➤ INTERVISTA ME GOJË

Intervista me gojë konsiston kryesisht në përgjigjet e pyetjeve rreth Legjislacionit të Arsimit të Lartë, Legjislacionit për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor, Legjislacionin e Prokurimeve Publike, Kodin e Procedurave Administrative, Kodin e punës në RSH, Legjislacionin për Rregullat e etikës në administratën publike".

#### ➤ PROCEDURA E PËRZGJEDHJES

1. Lista e kandidatëve që plotësojnë kriteret kualifikuese miratohet nga Senati Akademik dhe I kalon Bordit të Administrimit.
2. Bordi I Administrimit shqyrton dosjen e secilit kandidat dhe vlerëson atë me 70% të pikëve totale.
3. Vlerësimi I njohurive dhe aftësive të kandidatëve lidhur me zbatimin e detyrave si Administrator i UAR, do të kryhet nëpërmjet intervistës me gojë, e cila do të përmbajë pyetje të strukturuar nga çdo anëtar I bordit. Ky vlerësim do të llogaritet me 30% të pikëve totale. Pikët totale të vlerësimit janë 100 pikë. Kandidati që shpallet fitues duhet të marrë mbi 50 pikë.

- Emërimi I Administratorit të institucionit bëhet nga Bordi I Administrimit.
- Kriteret për vendin e punës për Administratorin e UAR të shpallen në Buletinin e APP.
- Ngarkohet për vazhdimin e procedurave për vazhdimin e procedurave të konkurimit për këtë vend pune, mbështetur në aktet ligjore dhe nenligjore në fuqi, Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore ne Universitetin e Arteve.

**Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.**





**BORDI I ADMINISTRIMIT I UNIVERSITETIT TË ARTEVE**

**Elira Kokoná**

(kryetare)

**Prof. Artan Peqini**

(anëtar)

**Prof. Besnik Bisha**

(anëtar)

**Prof. Arben Basha**

(anëtar)

**Dhimitër Bako**

(anëtar)

**Erjon Ndroqi**

(anëtar)

**Arjan KONOMI**

(anëtar)